



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË**



**Përmbledhje
E Mbledhjes së Dytë të Komitetit Kombëtar të Pagesave (KKSP)**

e cila u mbajt

të premtën, datë 24 Maj 2016, nga ora 10.00 deri 13.30 në ambientet e Selisë Qendrore të Bankës së Shqipërisë

Mbledhja e dytë e KKSP u hap me një fjalim përshëndetës të kryetares zj. Gjoni. Në fjalimin e saj zonja Gjoni falënderoi anëtarët për kontributin e deritanishëm në kuadër të përmbushjes së objektivave strategjik të Komitetit. Gjithashtu, kryetarja falënderoi edhe përfaqësues të institucioneve financiare jo banka, operatorët e elementëve të rëndësishëm të sistemeve të pagesave dhe kompanitë utilitare për pjesëmarrjen në këtë mbledhje. Në fjalimin e saj zj. Gjoni theksoi rolin që luajnë sistemet dhe instrumentet e pagesave në aktivitetin ekonomik dhe rëndësinë e funksionimit të Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave në koordinimin e politikave ndër-institucionale në këtë fushë. Në këtë kuadër zj. Gjoni bëri një prezantim të përmbledhur të projekteve të ndërmarra nga KKSP deri më tani, si dhe prezantoi disa projekte të reja të parashikuara nga Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me institucione të mirë njohura ndërkombëtare, si Banka Botërore.

Seksioni mbi zhvillimet më të fundit në fushën e inovacionit, si dhe forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit ndër-institucional, filloi me një fjalim të zj. Harito, Ministër i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, mbi zhvillimet më të fundit në fushën e inovacionit në lidhje me shërbimet qeveritare. Më konkretisht zj. Harito prezantoi zhvillimet më të fundit lidhur me projektet e ndërmarra në fushën e dixhitalizimit të shërbimeve qeveritare nga ana e Ministrisë, ku pas krijimit të infrastrukturës, ambientit ligjor dhe rregullativ të nevojshëm, po intensifikohen gjithnjë e më shumë përpjekjet për zgjerimin e gamës së shërbimeve të ofruara nga e-Albania. Në këtë kontekst, zj. Harito vlerësoi me rëndësi të veçantë krijimin e urave të komunikimit mes shoqërive utilitare dhe bankave tregtare për realizimin e tyre. Për më shumë, ministria Harito theksoi rëndësinë e promovimit të mënyrave inovative të pagesave, si ato me celular, që vlerësohet të jenë e ardhmja e pagesave dhe në këtë kuadër Ministria dhe Banka e Shqipërisë do të intensifikojnë ndërveprimin. Theks të veçantë gjatë fjalimit të saj zj. Harito i kushtoi dhe rëndësisë së përdorimit të firmës elektronike në shërbimet bankare, por dhe më gjerë.

Në vijim, fjalën e mori përfaqësuesi i Ministrisë së Financave, z Lavdrim Sahitaj, i cili nënvizoi se zbatimi i praktikave inovative duhet të bazohet në një proces të kujdesshëm dhe bashkëpunues midis institucioneve me qëllim adresimin e aspekteve kulturore, të cilat mund krijojnë barriera në praktikë. Gjithashtu, u theksua se Ministria e Financave, në kuadër të procesimit automatik të pagesave, është duke bashkëpunuar me kompanitë utilitare me qëllim standardizimin e urdhërpagesave të tyre të dërguara pranë thesarit.

Zj. Elona Gjebrea, Zëvendësministre e Punëve të Brendshme, diskutoi mbi zhvillimet lidhur me projektin e krijimit të regjistrit elektronik të Gjendjes Civile dhe Adresarit nga ana e Ministrisë. Në këtë kuadër zj. Zëvendësministre bëri një prezantim të detajuar mbi këtë projekt duke i kushtuar vëmendje të veçantë përfitimeve të cilat do të kenë aktorë të ndryshëm nga ky regjistër si dhe funksionalitetet e sistemit. Në prezantimin e saj zj. Gjebrea paraqiti planin e veprimit të parashikuar për realizimin e këtij projekti si dhe standardet evropiane mbi të cilat po bazohet ky projekt. Ajo nënvizoi se një nga përfituesit kryesor të këtij projekti është sistemi bankar, duke lehtësuar kështu ndjeshëm procesin e identifikimit të klientit dhe të pasurive të tyre, të cilat përdoren si kolateral.

Në vijim të programit të mbledhjes Zëvendësministri i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes, z. Ervin Mete, mbajti një prezantim mbi çështje që lidheshin me mbrojtjen e konsumatorit dhe nevojat për bashkëpunim midis Ministrisë dhe Bankës së Shqipërisë. Në prezantimin e tij z. Mete shpjegoi kompetencat e Ministrisë që përfaqëson, në kuadër të mbrojtjes së konsumatorëve nga pikëpamja e shërbimeve bankare dhe rëndësinë e krijimit të strukturave dhe procedurave të ngjashme me ato të Bashkimit Evropian. Në këtë kuadër, Zëvendësministri, pasi prezantoi gjetjet e Ministrisë nga monitorimi i bërë sistemit bankar në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, nënvizoi pikat kyçe dhe nevojën për bashkëpunim midis Bankës dhe MZHESTS për transpozimin e disa direktivave dhe rregulloreve të rëndësishme të fushës.

Në mbështetje të nevojës për ndërhyrje në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit ndërhyri dhe Z. Frédéric Blanc, Anëtar i Bordit Drejtues të Shoqatës Shqiptare të Bankave. Z. Blanc propozoi se përtej çështjeve që lidhen me kostot, të cilat mbartin konsumatorët nga përdorimi i shërbimeve bankare, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet edukimit financiar, dhe në këtë kuadër z. Blanc propozoi një përjasje shumëdimensionale ku të përfshihen të gjithë palët e interesuara.

Seksioni i dytë i mbledhjes mbi zhvillimet më të fundit në sistemet e pagesave dhe ecurinë mbi rekomandimet e mbledhjes së parë të komitetit, vijoi me një prezantim të zj. Anjeza Beja, Drejtor Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, mbi zhvillimet më të fundit në sistemet dhe instrumentet e pagesave në tregun shqiptar. Në përfundim të prezantimit të saj, zj. Beja prezantoi dhe arritjet e grupeve të punës të ngritura në kuadër të adresimit të rekomandimeve të lëna nga KKSP në mbledhjen e parë të tij. Më konkretisht, zj. Beja prezantoi planin e veprimit për materializimin e projektit të Debitimit Direkt ndërbankar, i cili pasqyron interesin e bankave për pjesëmarrje në skemën e debitimit direkt ndërbankar si dhe afatet e nevojshme për realizimin e etapave, si nga pikëpamja infrastrukturore, ashtu edhe atë rregullative.

Në vazhdim të prezantimit të saj, zj. Beja paraqiti edhe formatin e unifikuar të urdhërpagesës të dakorduar midis bankave. Standardizimi i sipërcituar është bazuar në praktikat më të mira evropiane dhe më konkretisht ato të SEPA, dhe vlerësohet të krijojë themelet për procesimin automatik të pagesave në të ardhmen. Ky projekt konsiderohet si një hap i parë drejt realizimit të projektit të faturës elektronike në ekonominë shqiptare.

Në kuadër të realizimit të projekteve të ngritura nga rekomandimet e mbledhjes së parë të KKSP, z. Spiro Brumbulli, Sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës Shqiptare të Bankave, prezantoi gjetjet e studimit mbi matjen e kostove të pagesave në euro brenda vendit. Në prezantimin e tij z. Brumbulli fillimisht dha një panoramë mbi përdorimin e euros si mjet pagesa brenda vendit, me qëllim identifikimin e rëndësisë që ato kanë për ekonominë shqiptare. Në vijim të prezantimit, z. Brumbulli analizoi gjetjet e studimit mbi matjen e kostove të pagesave brenda vendit në euro. Studimi i sipërcituar bazohej në një vërtetim mbi matjen e kostove nga përdorimi i bankave korrespondente, si dhe matjen e kostove nga administrimi i pagesave *cash* në euro brenda vendit. Nga gjetjet e këtij studimi rezulton se kostot, të cilat mbart realizmi i pagesave në euro brenda vendit me metodat aktuale është relativisht i lartë. Në këtë drejtim do të vijohet të analizohen mundësitë e rritjes së efikasitetit të tregut në këtë drejtim.

Në përfundim të prezantimit z. Blanc gjithashtu theksoi kostot tepër të larta të cilat mbart përdorimi i bankave korrespondente për pagesat në valutë brenda vendit dhe nevojën për ndërhyrje të mundshme në këtë kuadër.

Në vijim të mbledhjes fjalën e mori zj. Najada Xhaxha, Kryetare e Komitetit të Pagesave pranë Shoqatës Shqiptare të Bankave. Në fillim të fjalës së saj zj. Xhaxha shprehu interesin e sistemit bankar në kuadër të bashkëpunimit me Ministrinë e Punëve të Brendshme për mundësi të përdorimit të regjistrimit të integruar të adresave dhe shtetasve. Në këtë kuadër zj. Xhaxha theksoi se një nga nevojat kryesore të sistemit bankar është *“know your customer”*, dhe krijimi i një baze të tillë të dhënash do të ndihmojë ndjeshëm sistemin bankar në realizimin sa më efikas të kësaj kërkesë.

Zj. Xhaxha vazhdoi fjalën e saj me rëndësinë që paraqet zhvillimi i skemës së debitimit direkt për tregun shqiptar si nga perspektiva e konsumatorit, ashtu edhe ajo e biznesit. Në këtë këndvështrim, zj. Xhaxha nënvizoi se përdorimi i debitimit direkt ndërbankar nga pikëpamja e konsumatorit do të krijojë mundësinë e përdorimit të këtij shërbimi për pagesat utilitare, pavarësisht ekzistencës së një marrëveshjeve që ka banka e tij me kompanitë në fjalë. Ndërkohë që nga perspektiva e biznesit, debitimi direkt ndërbankar mundëson reduktimin e llogarive të tyre në sistemin bankar, duke lejuar përzgjedhjen e bankës dhe lehtësuar procedurat e rikoncilimit si dhe administrimit të likuiditetit. Megjithatë, zj. Xhaxha theksoi se realizimi me sukses i këtij projekti kërkon një bashkëpunim të ngushtë të sistemit bankar me kompanitë utilitare.

Seksioni i dytë i mbledhjes u mbyll me një prezantim të z. Deniz Deralla, Drejtor i Departamentit të Mbikëqyrjes mbi implementimin e nënshkrimit elektronik në shërbimet bankare. Në këtë kuadër, z. Derralla pasi analizoi kuadrin rregullativ të Bankës së Shqipërisë dhe legjislativin për zbatimin e nënshkrimit elektronik, duke pasur si objektiv sqarimin se implementimi i nënshkrimit elektronik mbështetet nga kuadri rregullativ i Bankës së Shqipërisë dhe në asnjë rast nuk krijon barriera. Për më shumë z. Derralla tha se Banka e Shqipërisë nëpërmjet ndryshimeve rregullative të ndërmarra vitet e fundit, synon promovimin edhe të metodave më të avancuara të komunikimit virtual me klientët, në kushtet kur bankat po investojnë sot në teknologjitë inovative. Gjithashtu, z. Derralla nënvizoi se Banka e Shqipërisë vlerëson dhe mbështet nismat për sensibilizimin e bankave për rritjen e efikasitetit të shërbimeve bankare, midis të tjerash edhe nëpërmjet përdorimit të nënshkrimit elektronik. Në këtë aspekt, Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të mbështesë përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve bankare, edhe nëpërmjet ndryshimeve rregullative të nevojshme.

Seksioni i fundit i mbledhjes së Komitetit filloi me një prezantim të znj. Maria Teresa Chimenti, përfaqësuese e Grupit të Zhvillimit të Sistemeve të Pagesave pranë Bankës Botërore, mbi studimin e kostove të instrumenteve të pagesave nga kahu i kërkesës. Më konkretisht, studimi i sipërcituar bazohet në një metodologji të hartuar nga Banka Botërore, e cila synon të masë kostot e gjeneruara nga një gamë tepër e gjerë faktorësh si nga kahu i kërkesës (individët, bizneset dhe agjencitë shtetërore), ashtu edhe nga kahu i ofertës (institucione bankare dhe financiare). Aktualisht, Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Bankën Botërore, kanë finalizuar analizën e kahut të kërkesës, ku rezultatet e para tregojnë një përdorim të lartë të parasë fizike në ekonomi, e cila në terma të produktivitetit efektiv i kushton ekonomisë shqiptare relativisht shumë. Në përfundim të studimit edhe të kahut të ofertës, Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim edhe me aktorë të tjerë të tregut, do të synojë krijimin e një strategjie, e cila do të adresojë: a) analizimin dhe kuptimin e kostove reale dhe sociale të përdorimit të instrumenteve të pagesave; b) mbështetjen e procesit vendimmarrës në kuadër të modernizimit të sistemeve dhe shërbimeve të pagesave; c) identifikimin e hapësirave për reduktim të kostove në varësi të rezultateve; dhe d) nxitjen e dialogut të aktorëve të tregut bazuar në rezultate konkrete.

Mbledhja e KKSP përfundoi me ndërhyrjet e të ftuarve nga institucionet financiare jo banka, operatorët e elementëve të rëndësishëm të sistemeve të pagesave dhe kompanitë utilitare. Ndërhyrja e tyre konsistoi kryesisht në prezantimin e veprimtarisë që ata ushtrojnë në treg si dhe nënvizimin e disa problematikave të cilat hasin në ushtrimin e këtyre veprimtarive në tregun vendas

Rekomandimet e mbledhjes së dytë të Komitetit Kombëtarë të Sistemit të Pagesave.

1. Projekti i Debitimit Direkt Ndërbankar
 - a) Zbatimi i planit të veprimit dhe ndërmarrja e hapave të nevojshëm për implementimin e tij. Ngritja e një grupi pune në Bankën e Shqipërisë dhe caktimi i personave kyç të kontaktit në çdo bankë për realizimin e projektit të debitimit direkt ndërbankar si nga pikëpamja e zhvillimit të infrastrukturës, ashtu edhe kuadrit rregullativ të nevojshëm.
 - b) Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike dhe/ose Ministria e Financave, angazhohen të koordinojnë dhe lehtësojnë komunikimin mes bankave tregtare, nëpërmjet Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe shoqërive utilitare, me qëllim realizimin e projektit të debitimit direkt ndërbankar.
2. Vijimi i komunikimeve midis Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme në lidhje me nxitjen e sigurisë dhe efikasitetit të shërbimeve bankare dhe Financiare, nëpërmjet ndërlidhjes me regjistrin elektronik të gjendjes civile dhe adresarit.
3. Vijimi i punës për përfundimin e fazës së dytë të projektit me Bankën Botërore, për matjen e kostos së instrumenteve të pagesave (kahu i ofertës). Shoqata Shqiptare e Bankave të ofrojë mbështetjen e nevojshme për koordinimin e komunikimit mes personave të kontaktit në Bankën e Shqipërisë, bankave tregtare dhe Bankës Botërore.

4. Fillimi i punës nga ana e Bankës së Shqipërisë për implementimin e dy projekteve të reja me Bankën Botërore:
- Projekti për përfshirjen financiare, me qëllim vlerësimin dhe hartimin e një strategjie të përfshirjes financiare për nga këndvështrimi i pagesave, e cila në thelb do të synojë që t'i mundësojë individëve akses në ofruet të shërbimeve të pagesave .
 - Projekti për remitancat, i cili synon të analizojë dërgesat e emigrantëve në një ose disa rajone të Shqipërisë me dërgesa të larta, me qëllim të kuptuarin e faktorëve socialë dhe financiarë që ndikojnë në dërgimin dhe përdorimin e këtyre fondeve. Synimi përfundimtar i këtij projekti do të jetë zgjerimi i përdorimit të instrumenteve të pagesave në procesin e dërgimit dhe kanalizimit të remitancave dhe mundësimi i shërbimeve më të lira dhe më lehtësisht të aksesueshme për emigrantët dhe familjet e tyre. Në varësi të planit të veprimit për implementimin e tyre, kërkohet mbështetja e Bankës së Shqipërisë nga ana e institucioneve pjesëmarrëse në Komitet.

6. Propozimi për mbledhjen e radhës: Nëntor 2016

Pjesëmarrësit në mbledhjen e KKSP			
Anëtarët e Komitetit	Sekretariati	Shoqërues të anëtareve	Të ftuar
Zj. Elisabeta Gjoni Banka e Shqipërisë (BSH)	Zj. Valentina Semi (BSH)	Zj. Mimoza Peco (MF)	Zj. Eneida Thomaj (Paylink)
Zj. Milena Harito Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike (MIAP)	Z. Spiro Brumbulli (SHSHB)	Zj. Aurela Velo (MF)	Zj. Irida Huta (Paylink)
Zj. Elona Gjebrea Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)		Zj. Vilma Tomço (MIAP)	Zj. Elona Lekloti (MPesa)
Z. Ervin Mete Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS)			Z. Dorien Mece (MPesa)
Z. Lavdrim Sahitaj Ministria e Financave (MF)			Zj. Ludovic Laventure (MPay)
Z. Frederic Blanc Shoqata Shqiptare e Bankave (SHSHB)			Zj. Linda Shomo (Easypay)
Zj. Najada Xhaxha Shoqata Shqiptare e Bankave(SHSHB)			Zj. Albana Ferraj (OSHEE)
Zj. Anjeza Beja Banka e Shqipërisë (BSH)			Z. Altin Uka (OSHEE)
Z. Deniz Deralla Banka e Shqipërisë (BSH)			Z. Johan Sterjo (OSHEE)
			Z. Andi Erebara (OSHEE)
Të ftuar për prezantim/ Pjesëmarrje			
Maria Teresa Chimenti Banka Botërore			

Nenad Bosiljcic Banka Botërore			